



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA / REPUBLIC OF KOSOVA
QEVERIA E KOSOVËS / VLADA KOSOVA / GOVERNMENT OF KOSOVA
MINISTRIA E PUNËS DHE MIRËQENIES SOCIALE

Zyra për Komunikim Publik



**SHËRBIMET QË OFRON MPMS-JA
PËR QYTETARËT E KOSOVËS**

Korrik 2009

ZYRA PËR KOMUNIKIM PUBLIK

Duke lexuar këtë broshurë, lexuesi-qytetari i Kosovës do të njihet me fushëveprimin e Ministrisë së Punës dhe Mirëqenies Sociale (MPMS), gjegjësisht me shërbimet që kjo ministri ofron për qytetarët e Republikës së Kosovës, pa dallim feje, race, gjinie apo etnie.

Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale, si strukturë përbërëse e Qeverisë së Republikës së Kosovës, angazhohet maksimalisht në zbutjen e problemeve sociale, ofrimin e shërbimeve të nevojshme për të punësuarit, trajnime për punëkërkuarit që të aftësohen në ato profile që i kërkon ekonomia e tregut. Kjo ministri merret dhe përkujdeset për kategoritë më të ndjeshme të shoqërisë sonë siç janë familjet e dëshmorëve, invalidët e luftës, pensionistët, të papunët si dhe qytetarët e të gjitha moshave e nacionaliteteve me nevoja të veçanta.

Në fushëveprimin e vet MPMS ka:

- Politikat dhe strategjitë në fushën e punësimit, mirëqenies sociale, aftësimin profesional dhe sigurinë në punë për të punësuarit,
- Harton dhe përgatit legjislacionin primar dhe sekondar në fushat e lartpërmendura,
- Nxiti dhe përkrah marrëdhëniet jodiskriminuese të pu-

nës duke aplikuar standarde ndërkombëtare të punës,

- Mbikëqyrë kërkesën dhe ofertën e tregut të punës,
- Siguron përkrahje sociale nga mjetet buxhetore për familjet dhe personat nevojtarë,
- Nxiti punësimin dhe propozon masa përkatëse për ta shtuar punësimin,
- Hulumton tregun e punës,
- Përkrah në forma të ndryshme aftësimin profesional për punëkërkuarit.
- Inkurajimi i dialogut social dhe pjesëmarrja në bashkëbisedime me partnerët social (sindikatave, punëdhënësve dhe organizatatave të tyre).

Gjithë aktivitetin dhe veprimtarinë e vet MPMS-ja e realizon përmes shtatë departamenteve dhe Trupës Ekzekutive të Inspektoratit të Punës si dhe njësisve tjera përbërëse.

DEPARTAMENTET

1. Departamenti Ligjor (DL)
2. Departamenti i Shërbimit Qendror të Administratës (DShQA)
3. Departamenti i Punës dhe Punësimit (DPP)
4. Departamenti i Administratës Pensionale (DAP)
5. Departamenti i Mirëqenies Sociale
6. Departamenti i Familjeve të Dëshmorëve dhe Invalidëve të Luftës
7. Departamenti i Institutit për Politika Sociale (DIPS)
8. Trupa Ekzekutive e Inspektoratit të Punës.

Shërbimet që ofrohen përmes departamenteve për qytetarët e Republikës së Kosovës

Departamenti Ligjor harton legjislacionin primar dhe sekondar, në bashkëpunim të ngushtë me Kabinetin e Ministrisë, me departamentet dhe njësitë tjera organizative nga fushëveprimtaria e MPMS-së.

Departamenti i Shërbimit Qendror të Administratës si departament funksionon me qëllim të ofrimit të përkrahjes administrative, logjistike infrastrukturore dhe arkivore për nivelin qendror dhe atë lokal të MPMS.

Departamenti i Punës dhe Punësimit është instrumenti kyç për adresimin e problemeve strukturore në tregun e punës, krijimin dhe dizajnimin e politikave të punësimit dhe të aftësimeve profesionale për punëkërkuarit si dhe zhvillimin e dialogut social në Kosovë. Aktivitetin e vet ky departament e zhvillon përmes shtatë Qendrave



Regionale të Punësimit, 23 Zyrave komunale të punësimit, gjashtë Nënzyrave Komunale të Punësimit dhe tetë Qendrave të Aftësimit Profesional.

Përmes shërbimeve të punësimit, prej vitit 2000 e deri më tani, janë regjistruar 335 mijë e 942 punëkërkuar. Janë gjetur rreth 51 mijë e 176 vende të lira të punës, kurse përmes procedurës së ndërmjetësimit në punësim janë punësuar 44 mijë e 800 punëkërkuar. Gjithashtu përmes këtyre shërbimeve janë këshilluar lidhur me punën dhe punësimin rreth 211 mijë punëkërkuar.

MPMS për çdo vit organizon Projektin e Punëve Publike në Kosovë, ku në bashkëpunim me komunitetin, për kohë të caktuar disamujore, punë gjejnë mesatarisht 1 mijë deri në 1 mijë e 200 punëkërkuar, ku përveç përfitimit material për punëkërkuarit, ky projekt dukshëm ndikon edhe në krijimin e një ambienti më të pastër në qytete e fshatra të Kosovës.

Shërbimet që ofron MPMS-ja për qytetarët e Kosovës

Me qëllim të aftësimit profesional të punëkërkuësve, MPMS-ja ka hapur tetë Qendra të Aftësimeve Profesionale që gjenden në shtatë qendra regjionale të Kosovës, në të cilat qendra ofron trajnime falas në 28 profesione të zgjedhura në bazë të analizës së tregut të punës, që organizohen në 56 punëtori. Të gjitha këto punëtori janë të pajisura me mjetet më bashkëkohore që mundësojnë trajnim kualitativ teorik dhe praktik. Në të gjitha qendrat është organizuar Kursi i Vetëpunësimit, të cilin mundë ta ndjekin të gjithë punëkërkuësit të cilët kanë ide biznesi. Trajnimet janë falas, ndërsa për kandidatët që janë shfrytëzues të asistencës sociale, përmes Projektit “Lux-Development” u paguhen shpenzimet e udhëtimit. Aktualisht në trajnime janë të përfshirë 1 mijë e 600 kandidatë.

Departamenti i Administratës Pensionale Ky departament ofron shërbime për qytetarët në harmoni me aktet ligjore dhe nënligjore që rregullojnë çështjen e pensioneve në Kosovë. Sipas këtij legjislacioni aktualisht janë duke u zbatuar këto skema të pensioneve:



1. Pensioni bazë, apo pensioni i pleqërisë, ku mundë të përfitojnë të gjithë qytetarët e Republikës së Kosovës të moshës mbi 65 vjeç.
2. Pensioni themelor për ata qytetarë që kanë paguar sigurime pensionale e që kanë së paku 15 vite stazh pune.

Shërbimet që ofron MPMS-ja për qytetarët e Kosovës

3. Pensioni për personat me aftësi të kufizuar- për të gjithë qytetarët që janë 100% të paafte për punë, të moshës mbi 18 vjeçare.

4. Pensionet e parakohshme “Trepça” (Kjo skemë menaxhohet nga menaxhmenti i Kombinatit “Trepça”, monitorohet dhe administrohet nga MPMS-ja).

5. Pensionet për ish-pjesëtarët e Trupave Mbrojtëse të Kosovës (Pensionet e parakohshme-mosha 45 vjeçare dhe të kenë shërbyer së paku 5 vite në TMK dhe pensionet e përhershme-mosha mbi 50 vjeçare).

Duke u bazuar në marrëveshjet e vitit 1968 për sigurimin pensional dhe invalidor me vendet tjera, përmes MPMS-së, qytetarët tanë që kanë punuar në vendet tjera e që kanë paguar sigurimet pensionale e invalide, mund të sigurojnë pensionin e pleqërisë, pensionin familjar pensionin invalidor dhe kthimin e kontributeve. Sikurse shërbimet tjera edhe këto shërbime ofrohen përmes shtatë Qendrave Regjionale dhe Zyrave komunale të Administratës Pensionale, në tërë territorin e Kosovës.

Departamenti i Mirëqenies Sociale- Përmes këtij departamenti MPMS ofron mbështetje financiare dhe shërbime tjera sociale për të gjithë qytetarët me nevoja të veçanta. MPMS zbaton Skemën e Asistencës Sociale, ku shfrytëzuesit në këtë skemë janë të ndarë në dy kategori: Në kategorinë e parë që ka për qëllim t’u siguroj ndihmë financiare familjeve të cilat nuk kanë asnjë anëtarë të familjes të aftë për punë, apo nuk presin të aftësohen për punë dhe në kategorinë e dytë që gjithashtu ka për qëllim sigurimin e ndihmës financiare familjeve me anëtarë të aftë për punë, por që për momentin nuk mund të sigurojnë punë e janë në gjendje të rëndë ma-

teriale. Nga kjo skemë përfitojnë rreth 35 mijë familje me mbi 155 mijë anë tarë të familjes, kurse shuma mesatare mujore për një familje është 60 euro. Gjithashtu MPMS nga fillimi i vitit 2009 ka filluar së zbatuari skemën e përfitimeve materiale për familjet që kujdesen për fëmijët me aftësi të kufizuara deri në moshën 18 vjeçare. Përfitues nga kjo skemë janë familjet që kujdesen për fëmijët me aftësi të kufizuar të përhershme siç janë fëmijët e verbër, fëmijët e palëvizshëm dhe fëmijët që nuk mund të kujdesen për nevojat e veta fiziologjike e kanë nevojë për përkujdesje 24 orëshe. Përveç skemave të lartpërmendura MPMS për qytetarët e Republikës së Kosovës ofron edhe shërbime tjera sociale që bazohen në legjislacionin ekzistues të zbatueshëm në Kosovë.

Falë një bashkëpunimi të shkëlqyeshëm që zhvillon MPMS-ja me OJQ-të (SOS-Kinderdorf, Hopen Homes, Every Child) janë krijuar kushtet që fëmijët e braktisur të vendosen në shtëpi të vogla me karakter të përkohshëm, ose në familje deri sa Qendra për Punë Sociale të gjejë format më adekuate të mbrojtjes. Poashtu kujdes i veçantë tregohet edhe ndaj fëmijëve të abuzuar dhe të keqtrajtuar, ndaj atyre me sjellje asociale dhe delikenteve të mitur. Një formë tjetër e mbrojtjes së fëmijëve është strehimi familjar për fëmijët pa përkujdesje prindërore. Familja ku është vendosur fëmija ka të drejtën e kompensimit material deri në 150 euro në muaj, kurse kur strehimi realizohet tek të afërmit e fëmijës pagesa është 75 euro në muaj.

Personat e moshuar pa përkujdesje familjare dhe ata me aftësi të kufizuar mbrojtjen institucionale e realizojnë përmes Shtëpisë për Persona të Moshuar pa Përkujdesje Familjar në Prishtinë, në Institutin Special në Shtime dhe në Shtëpitë me Bazë në Komunitet në Skenderaj, Gurrakoc, Shtime, Graçanicë, Ferizaj, Vushtrri, Dar-

danë dhe Deçan.

Të gjithë shfrytëzuesit e ndihmës sociale dhe ata që përfitojnë nga skema e familjeve të dëshmorëve, invalidëve të luftës dhe familjeve me viktime civile të luftës mund të aplikojnë për shlyerjen nga 20 kw/h të energjisë elektrike në muaj, që e bënë MPMS-ja në bashkëpunim me KEK-un dhe MEF-in. Të gjitha këto shërbime MPMS i realizon përmes rrjetit të QPS-ve që janë të shtrira në të gjitha Komunitetet e Republikës së Kosovës.

Me qëllim të promovimit, zhvillimit dhe begatimit të njohurive, shkathtësive dhe standardeve profesionale në fushën e shërbimeve sociale dhe familjare MPMS ka themeluar Institutin për Politika Sociale që për mision ka angazhimin në partneritet me bashkësinë, të cilës edhe i shërben për përmirësimin e cilësisë së jetëve të të gjithë njerëzve në nevojë në Republikën e Kosovës. Aktivitetin e vet ky departament e zhvillon në koordinim dhe bashkëpunim të drejtpërdrejtë me QPS-të dhe Drejtoritë Komunale për Punë dhe Mirëqenie Sociale.

Departamenti i Familjeve të Dëshmorëve dhe Invalidëve të Luftës-Fushëveprim i përgjithshëm i këtij departamenti është menaxhimi, koordinimi, mbikëqyrja dhe administrimi i pensioneve dhe beneficioneve si dhe i të drejtave tjera të veçanta për personat, që me angazhimin e tyre, në çfarëdo forme, ndihmuan për lirinë e Kosovës, apo u viktimizuan për këtë çështje.

(Të drejtën në pension sipas Ligjit Nr. 02/L-2 e kanë realizuar 2 mijë e 71 familje të dëshmorëve, 19 familje të ushtarëve të zhdukur të UÇK-së, 4 mijë e 995 familje të viktimave civile të luftës, 277 familje të të zhdukurve civil, 2 mijë e 8 qind e 11 invalidë të UÇK-së, 49 kujdestarë të invalidëve të luftës, 32 familje të invalidëve të luftës pas vdekjes së invalidit, pra në bazë të legjis-

Shërbimet që ofron MPMS-ja për qytetarët e Kosovës

lacionit ekzistues që rregullon këtë çështje deri më tani kanë përfituar 11 mijë e 935 familje dhe individë, që kap shumën prej 43 milionë 609 mijë e 725 euro, kurse në banjat e Pejës dhe Kllokotit deri më tani për rehabilitim janë dërguar 1 mijë e 166 invalidë, kurse për rehabilitim fizikal dhe shëndetësore në dete për këto kategori janë ndarë 304 mijë euro. Për realizimin e projekteve të ndryshme të OJQ-ve, që kanë pasur të bëjnë me kategoritë e dala nga lufta janë ndarë deri më tani 768 mijë euro.

Të gjithë ata qytetarë të Kosovës, që i plotësojnë kriteret e parapara të Ligjit për vlerat e luftës së UÇK-së të drejtat e tyre mundë t'i realizojnë përmes zyrave të DFDIL, që veprojnë në të gjitha komunat e Kosovës.

Trupa Ekzekutive e Inspektoratit të Punës – Përmes kësaj trupe, MPMS-ja në mënyrë unike bënë kontrollimin e të gjitha vendeve të punës, kushtet e punës, mbrojtjen në punë dhe ruajtjen e shëndetit të të punësuarve. Poashtu në mënyrë të drejtpërdrejtë siguron informacione dhe këshilla për punëmarrësit dhe punëdhënësit për dispozitat ligjore të aplikueshme në Kosovë, që rregullojnë lëmin e punës, punësimin sigurisë në punë, mbrojtjen e shëndetit të të punësuarve dhe ambientit të punës.

Gjatë inspektimit të vendeve të punës inspektorët e punës veprojnë në ndalimin e të gjitha llojeve të diskriminimit në punë si punën e dhunshme ose të detyrueshme, organizimin sindikal, realizimin e pagesës së barabartë si për meshkuj ashtu edhe për femra, realizimin e pagave, orarin e punës, realizimin e pushimit ditor, javor, festave zyrtare, të lehonisë, pushimet vjetore, mjekësore, kushtet e punës, trajnimeve për punë të sigurt etj.

Këtë veprimtari kjo trupë e zhvillon përmes 51 inspektorëve të punës që veprojnë poashtu në të gjitha komunat e Kosovës.